

ROLI I VETËEFIKASITETIT PRINDËRORË NË ZHVILLIMIN E  
KOMPETENCËS SOCIALE DHE ÇRREGULLIMEVE EMOCIONALE TË  
FËMIJEVE

TEMA PËR TITULLIN  
MASTER I ARTEVE NË PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

NGA

BLEONA SHATRI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI FILOZOFIK  
DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË  
PRISHTINË  
KORRIK, 2021

ROLI I VETËEFIKASITETIT PRINDËRORË NE ZHVILLIMIN E KOMPETENCËS  
SOCIALE DHE ÇRREGULLIMEVE EMOCIONALE TË FËMIJEVE

NGA

BLEONA SHATRI

Mentori: Liridona Jemini-Gashi, Prof. Ass. Dr.

Vetë-efikasiteti i prindërve (PSE) është identifikuar si vlerësim i vetë-referencës së prindërve për aftësinë në rolin e prindërve ose si perceptime të prindërve për aftësinë e tyre për të ndikuar pozitivisht në sjelljen dhe zhvillimin e fëmijëve të tyre. Kjo përfshin si nivelin e njohurive specifike që kanë të bëjnë me sjelljet e përfshira në zhvillimin dhe rritjen e fëmijëve, ashtu edhe shkallën e besimit në aftësinë e një prindi për t'u përballur me situatat sfiduese me fëmijët e tyre (Coleman & Karraker, 1998; Kuhn & Carter, 2006). Këto aspekte ndikojnë në mënyrën e funksionimit të fëmijës në shumë fusha jetësore, përfshirë edhe në kompetencën emocionale dhe sociale të tyre. Kjo e fundit përshkruhet si aftësia për të bërë dhe mbajtur në mënyrë efektive rezultate pozitive sociale duke organizuar burimet vetjake dhe mjedisore (Buhs & Ladd, 2001). Fëmijët dhe adoleshentët me mungesë të kompetencës sociale, janë në rrezik për t'u ndeshur me ngjarje të pafavorshme të jetës të cilat nga ana tjetër mund të shkaktojnë depresion, ankth dhe stres (Grano et al., 2007).

Qëllimi i këtij studimi është të kuptoj rolin e vetëefikasitetit prindëror në zhvillimin e kompetencës sociale dhe çrregullimeve emocionale të stresit, ankthit dhe depresionit tek fëmijët, si dhe të kuptoj ndërlidhjen që ka kompetenca sociale me çrregullimet emocionale të fëmijëve të moshës dymbëdhjetë deri pesëmbëdhjetë vjeç.

Ky studim përmban këto pyetje hulumtuese: Cili është ndikimi i vetëefikasitetit prindëror në zhvillimin e kompetencës sociale? Cili është ndikimi i vetëefikasitetit të ulët në zhvillimin e

çrregullimeve të stresit, ankthit dhe depresionit? Cila është ndërlidhja në mes të kompetencës sociale, dhe çrregullimeve të stresit, ankthit dhe depresionit? Si dhe hipotezat: Vetëefikasiteti prindëror ka ndikim signifikant në zhvillimin e kompetencës sociale; Vetëefikasiteti i ulët prindëror ka ndikim signifikant në zhvillimin e çrregullimeve të stresit, ankthit dhe depresionit; Ekziston një ndërlidhje e rëndësishme negative në mes të kompetences sociale dhe çrregullimeve të stresit, ankthit dhe depresionit.

Për të dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore janë përdorur analizat e korrelacionit dhe regresionit. Analiza statistikore e regresionit linear është përdorur për të gjetur përgjigjen e dy pyetjeve kërkimore lidhur me ndikimin e vetëefikasitetit në kompetencën sociale, si dhe në çrregullimet emocionale të stresit, ankthit dhe depresionit. Kurse analiza korrelacionale u përdorë për të vërtetuar se cila është ndërlidhja ndërmjet kompetences sociale dhe çrregullimeve emocionale të stresit, ankthit dhe depresionit.

Rezultatet treguan se vetëefikasiteti prindërorë parashikoi në mënyrë signifikante nivelin e kompetences sociale  $F(170) = 96.015$ ,  $p = 0.01$  dhe shpjegoi 36% në ndryshueshmërinë e kompetencës sociale. Nga ana tjetër, vetëefikasiteti prindërorë kishte me pak ndikim në çrregullimet emocionale sesa në kompetencen sociale, mirëpo rezultatet ishin signifikante në të gjitha variablat. Vetëefikasiteti prindërorë parashikoi në mënyrë signifikante nivelin e stresit  $F(170) = 49.045$ ,  $p = 0.01$ , dhe shpjegoi 22% në ndryshueshmërinë e stresit. Vetëefikasiteti prindërorë parashikoi në mënyrë signifikante nivelin e ankthit  $F(170) = 54.549$ ,  $p = 0.01$ , dhe shpjegoi 24% në ndryshueshmërinë e akthit. Poashtu, vetëefikasiteti prindërorë parashikoi në mënyrë signifikante nivelin e depresionit  $F(170) = 49.045$ ,  $p = 0.01$ , dhe shpjegoi 21% në ndryshueshmërinë e depresionit.

Gjithashtu, rezultatet e korrelacionit për pyetjen e tretë kërkimore tregojnë se ka një lidhje të rëndësishme negative në mes kompetences sociale dhe stresit  $r(170) = -.432^{**}$ ,  $p < .001$ . Poashtu, rezultatet e korrelacionit treguan se kishte një lidhje të rëndësishme negative në mes kompetences sociale dhe ankthit  $r(170) = -.526^{**}$ ,  $p < .001$ , edhe me depresionin  $r(170) = -.449^{**}$ ,  $p < .001$ .

Mund të konkludohet se rezultatet e këtij studimi japin prova empirike të vlefshme për rëndësinë e vetëefikasitetin prinderore në dy variabla të rëndësishme për funksionimin psikosocial të fëmijes, konkretisht në atë të kompetencës sociale, dhe të çrregullimeve emocionale të stresit, ankthit dhe depresionit. Vetëefikasiteti prindëror po luan një rol të rëndësishëm direkt në mbrojtjen nga zhvillimi i problemeve të brendshme dhe të jashtme, në promovimin e mirëqenies socio-emocionale tek fëmijët. Përmes besimit që kanë në vetën e tyre prindërit arrijnë të krijojnë strategji pozitive të prindërimit dhe arrijnë të ballafaqohen me situatat sfiduese, duke nxitur kështu funksionimin adaptiv dhe rregullimin e socio-emocional tek fëmijët (Stack et al., 2010).

Poashtu, rezultatet e këtij studimi kanë treguar për ndërlidhjen e kompetencës sociale me çrregullimet emocionale të stresit, ankthit dhe depresionit. Kështu, kompetenca e ulët sociale mund t'i predispozojnë njerëzit për shqetësime psikologjike dhe shëndet të dobët mendor, dhe në disa raste, problemet e shëndetit mendor si ato të stresit, ankthit dhe depresionit mund të prishin përvetësimin ose zbatimin e kompetences së lartë shoqërore.

